

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIE - КОМУНА ВУШТРИ

QZ Nr./ Nr. 12/17

No. i fq./ Str. nr. _____

Data/ Datum 05.01.2017

VUSHTRRI - ВУШТРИ



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari i Komunës



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dt. 04.01.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formoj komisionin për verifikim të gjendjes ekonomike të familje të cilave komuna ua paguan qiranë e banimit.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1 Naim Ferizi, kryesues i komisionit
 - 2.2 Fitore Hyseni, anëtare
 - 2.3 Abaz Shyti, anëtar
3. Komisioni në fjalë duhet të bëjë verifikim të gjendjes ekonomike të familje të cilave komuna ua paguan qiranë e banimit. Komisioni, lidhur me punën e tij do të hartoj raport me shkrim për kryetarin e komunës duke propozuar për secilën familje se a duhet të vazhdohet të i paguhet qiraja e banimit, varësisht prej gjendjes ekonomike të atyre familjeve.
4. Komisioni, duhet ta dorëzoj raportin me shkrim më së largu deri më 10.01.2017.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi iu dërgohet: Drejtorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtarëve të komisionit, dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Barram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPÇISTINA VUÇITRIN
Nr. / Titull / Nr. 15 / 17
Nr. / Titull / Nr. _____
Data / Orari 10.01.2017
VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj znj. Arta Haxhaj, organ mbikëqyrës i projektit " **Krijimi i Platformës Ekonomikisht të Qëndrueshme për Mbledhjen dhe Paketimin e Mbeturinave të Riciklueshme**" (në fsh. Bukosh) i financuar nga Komisioni Evropian dhe Komuna e Vushtrrisë, që në bashkëpunim me z. Tefik Maloku dhe z. Abit Abiti, zyrtar mbështetës të saj në këtë projekt, që të hartoj raport me shkrim lidhur me implementimin në detaje të këtij projekti.
2. Raporti në fjalë duhet të dorëzohet në Zyrën e Kryetarit të Komunës më së largu deri më 16.01.2017.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa i dërgohet: të lartpërmendurës dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN
Nr. / Datum: 18/17
Nr. / Datum: 12.01.2017
VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenin 7 pika 5 në lidhje me nenin 12 pika 2 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë 01 nr.189/15, dt.29.09.2015, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj Drejtorinë si në vijim: Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorinë për Shërbime Publike, Drejtorinë për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtorinë për Prokurim Publik që mos të ju ofrojnë shërbime komunale administrative gjeneruesve të mbeturinave të cilëve ju ofrohen shërbimet e marrjes së mbeturinave, nëse i ka të pa paguara dy kësteve të njëpasnjëshme mujore të tarifës së mbeturinave.
2. Drejtori i secilës drejtori do të përcjellë zbatimin e kësaj urdhërese dhe do të raportoj te Kryetari/Nënkryetari i komunës në fund të çdo muaji kalendarik.
3. Urdhëresa hyn në fuqi dhe duhet të zbatohet nga dita e nënshkrimit.
4. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorive të cekura në pikën 1 (një) të së njëjtës dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRA
02 Sc./Br. 29/17
No. Ifig./Bil. sh.
Datim./Bilim. 16.01.2017
VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenit 13.5 të Rregullores për Dhënie e Dekorativë 01nr.186/13, dt.25.07.2013 me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje 01nr.88/15, dt.30.04.2015, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për kulturë Rini dhe Sport dt. 13.01.2017 i bazuar në njoftimin e Përgjegjësit të Sektorit të Sportit në kuadër të DKRS dt.12.01.2017, për shpalljen e sportistit të vitit për v. 2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. **Edona Kalludra**, anëtar e Klubit të Volejbollit "Vushtrria", e shpallur me vendim të jurisë profesionale "Sportiste e vitit 2016 –për grup moshë të reja" në nivel të komunës, i ndahen mjete financiare në shumë prej 300 (treqind euro).
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të bëhet nga mjetet buxhetore të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E VUSHTRRI - КОМУНА ВУШТРИ

Nr. / Titull / Nr. / Titull / Nr. / Titull
30/17

Nr. / Titull / Nr. / Titull / Nr. / Titull
16-01-2017

VUSHTRRI - VI ÇIFLËK



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenit 13.5 të Rregullores për Dhënie e Dekorativë 01nr.186/13, dt.25.07.2013 me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje 01nr.88/15, dt.30.04.2015, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për kulturë Rini dhe Sport dt. 13.01.2017 i bazuar në njoftimin e Përgjegjës të Sektorit të Sportit në kuadër të DKRS dt.12.01.2017 për shpalljen e sportistit të vitit për v. 2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **Z.Labinot Gubetini**, anëtar i klubit të hendbollit "Kosova" në Vushtri, i shpallur me vendim të jurisë profesionale "Sportist i vitit 2016 – vendi i parë për grup moshë të reja" për Komunën e Vushtrisë, i ndahen mjete financiare në shumë prej 300 (treqind euro).
2. Pagesa e mjeteve të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - ОПШТИНА ВУШТРИ

№ Nr. / Br. 31/17

№. / №. / Br. / st.

Data / Datum 16.01.2017

VUSHTRRIH - ВУШТРИН



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenit 13.5 të Rregullores për Dhënie e Dekoratave 01nr.186/13, dt.25.07.2013 me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje 01nr.88/15, dt.30.04.2015, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për kulturë Rini dhe Sport dt. 13.01.2017 i bazuar në njoftimin e Përgjegjësit të Sektorit të Sportit në kuadër të DKRS dt.12.01.2017, për shpalljen e sportistit të vitit për v. 2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. **Shqipe Tahiri**, anëtar e Klubit të Hendbollit "Kosova" në Vushtri, e shpallur me vendim të jurisë profesionale "Sportiste e vitit 2016 –për të rritur" në nivel të komunës, i ndahen mjete financiare në shumë prej 500 (pesëqind euro).
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të bëhet nga mjetet buxhetore të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

RE Nr. / Nr. 32/17

No. i fq. / No. of _____

Datim / Datum 16.01.2017

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenit 13.5 të Rregullores për Dhënie e Dekorativë 01nr.186/13, dt.25.07.2013 me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje 01nr.88/15, dt.30.04.2015, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për kulturë Rini dhe Sport dt. 13.01.2017 i bazuar në njoftimin e Përgjegjës të Sektorit të Sportit në kuadër të DKRS dt.12.01.2017, për shpalljen e sportistit të vitit për v. 2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **Z. Dardan Menxhiqi**, anëtar i klubit të Kikboksit "Kosova" në Vushtrri, i shpallur me vendim të jurisë profesionale "Sportist i vitit 2016 – vendi i parë për senior" në nivel të komunës, i ndahen mjete financiare në shumë prej 500 (pesëqind euro).
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të bëhet nga mjetet buxhetore të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës


Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOVOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - ОПШТИНА ВУШТРИ

№ i Protokollit: 33/17

№ i titullit / Nr. titullit: _____

Data / Datum: 16.01.2017

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari


Bazuar në nenin 13 dhe 62 pika 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/208) dhe nenin 67 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. z. **Betim Kollari** nga Vushtrria, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Inspektim në Vushtri.
2. Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat në pozitën e emëruar do t'i ushtrij konform me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, akteve tjera ligjore e nënligjore dhe urdhrave të Kryetarit të Komunës.
3. I lartpërmenduri realizon pagë mujore në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. I lartpërmenduri do të filloi me punë me datën 17.01.2017.
6. Vendimi iu dërgohet: Udhëheqësit të Personelit, të lartpërmendurit dhe arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës


Bajram Mulaku